

VENDIM
Nr. 295, datë 17.5.2023

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË Z. FATMIR PRIFTI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”; të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Fatmir Prifti në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku